

MIRATOHET

SEKRETAR I KKTKM

Sokol ISMAILI

## Specifikime teknike të projektit

# Punime për konservimin dhe restaurimin e Muzeut Etnografik Elbasan



Grupi i projektimit:

DRTK KORÇË

Ark. Albana Drenogllava

DREJTOR

Ark. Klajdi Dinellari

DHIMITRAQ PRISHKA

Ing. Denisi Dhima

## A. Të dhëna të përgjithshme

### Monument Kulture i Kategorise I-re

**Gjinia:** Ndertim i arkitektures popullore e tipit Banese me çardak

**Vendndodhja:** Bashkia Elbasan, Rruga “Qemal Stafa”, ne jug-lindje te sheshit “Aqif Pasha”, Lagjia “L. Gurakuqi”.

**Shpallur:** me Vendimin nr. 6 date 15/01/1963 shpallet monument kulture; me urdher nr. 927 date 16.10.2008 rishpallet monument nga M.T.K.R.S.-Drejt. e trashegimise kat. I, Vendim nr. 22 date 15.01.2005.

**Zona kadastrale:** Objekti eshte ndertuar ne ZK. 8521, ne parcelat me numer pronesia Nr. 1/120; nr. 1/121; nr. 1/201; pjeserisht nr. 1/183, pjeserisht 1/184, nr. 1/158.

Monumenti eshte nje godine 2 kateshe tipike elbasanase me hajat dhe çardak dikur ka sherbyer si Banesa e Sejdineve, sot  $\frac{1}{2}$  e tij eshte kthyer ne Muze Etnografik te qytetit Elbasan dhe administrohet nga ana e Bashkise Elbasan. Ky eshte muzeu i vetem etnografik i Qarkut Elbasan.

Monumenti ndodhet ne qender te qytetit Elbasan, ne anen lindore te sheshit « Aqif Pasha ».

Objekti eshte ndertuar në një terren të sheshtë dhe daton prej shek. XVIII -te.

**Koordinatat Gjeografike te objektit jane :** 20° 04' 59'' L    41° 06' 43'' V.

Objekti nuk ka zone te mbrojtur te shpallur por ka nje territor te rrethuar me mur me lartesi te ulet dhe me kangjella.



Vendodhja e  
Muzeut etnografik

### Pershkrim arkitektonik

Kati i pare ka nje korridor te madh dhe 4 dhoma te vizitueshme. Nderkati eshte prej druri shtruar me derrase. Tavanet jane te gjitha te dekoruar me motive te ndryshme nga njera tjetra. Ne kete objekt spikatin dekoret prej druri murale si dhe afreske ne faqet e brendshme te murit, gje qe tregon se banoret e saj dikur kane perfaqesuar nje familje te pasur dhe me nivel te larte te qytetit. Te gjitha dhomat kane ndricim te bollshem, dritare druri dhe me kanate druri. Dhomat e ndenjies per burra dhe per gra jane te vecanta dhe jane me oxhak. Ne ambjente eshte realizuar nje mobilim tipik i periudhes kur ka sherbyer objekti si banese. Vlere te vecante ne muze ka dhe fondi i prodhimeve dhe veshjeve te zbukuruara ne menyre artizanale. Ne anen perendimore ndodhen dhe dy ambjente me nje korridor te brendshem qe komunikojne me çardakun te cilat sot sherbejne si arkive dhe depo. Kati perdhe ka 3 dhoma dhe 1 holl. Ai sherbente dikur per ambjente pune sot ne te ekspozohen veglat e punes, pajisjet e punes dhe te ngrenies dhe produktet artizanale qe pergatiteshin ne kushte shtepie. Ne hyrje jane dhe tre ambjente + nje tualet + hajat, keto ambjente sot jane pershtatur per zyra. Kati perdhe ka rifinitura teper modeste sepse nuk ka gene e banuar, vetem kati I pate teknik ka gene i banuar.

### Pershkrim Konstruktiv

Muret jane të ndërtuar sipas teknikës së kohës me mure mbajtes prej guri dhe themele te vazhduar guri. Ndarjet e kateve janë të realizuara me trarë druri dhe veshje me dërrasa. Jane mure mbajtes me trashesi qe varion nga 40-60 cm. Kati i siperm eshte realizuar me mure te jashtme me çatma druri. Ndarjet e brendshme jane realizuar me parete druri tip çatma me suva ne dy anet, pjeserisht dhe me mure guri pjeserisht. Shkallet jane realizuar me beton dhe jne te nje periudhe me te vonë. Shkallet e vjetra referuar dokumentave te arkives kane qene prej druri ne fasaden kryesore nga jashte objektit. Çatia eshte me konstrukcion druri dhe mbulesa eshte me tjegulla vendi. Çardaku eshte mbeshtetur ne kollona druri dhe trare druri si pjesa tjetere e nderkatit e shtruar me dypsheme derrase.

### B. Ndërhryjet Restauruese

Nderhryjet konservuese dhe restauruese qe propozohen :

- Pastrim dhe suvatim i pjeseve te demtuara te suvase se mureve dhe çatmase jashte dhe brenda. Sugjerohet qe suvaja e demtuar te hiqet, te behet pastrimi i muratures me gur, vendosja e skelerise dhe me pas te realizohet suvatimi i ri sipas teknikes se perdorur. E njejta gje duhet te realizohet dhe per katin e siperm me parete prej çatmaje. Restaurimi i suvave te shpatullave te dritareve e dyerve.

## Punime për konservimin dhe restaurimin e Muzeut Etnografik Elbasan

- Trajtim dhe restaurim i dekoreve, dyshemese, tavanit pjeserisht, dhe fashaturave prej druri te amortizuar ne pjeset e demtuara perfshire dhe te gjithë elementet drusore do te trajtohen me vaj lini dhe solucion antimole.
- Restaurim i plote i çatise me tjegulla vendi njesoj me origjinalet, (duke perfshire elementet drusore te konstruksionit te çatise ne pjesen e demtuar, zevendesimin e shtreses se patavrave, vendosjen e shtreses hidroizoluese 1 k katrama, dhe mbulimit te saj me tjegulla te njejta me ato ekzistuese. Vendosjee impluveve me llamarinee xingato. Restaurim i strehes se çatise me tjegulla vendi me dekor (i cili ne segmente te caktuara eshte i ndryshem, duke respektuar rigorozisht detajin dhe materialin ekzistues perfshi ngjyren dhe materialin.
- Restaurimi i plote i tualetit, instalimeve, veshjes se dyshemese me pllaka gres imitim gur me ngjyre gri ose bezhe imitim parket druri, veshje e mureve me pllaka majolike ne kombinim me pllakat e poshtme pas konfirmimit nga mbikqyresi, zevendesimi i pajisjeve sanitare lavaman me mishilator dhe WC allafrenga me kaseten e shkarkimit te inkastruar, vendosje e depozites 500 litra , mbeshtetur ne strukture mbajtese metalike ne anen veriore te objektit sipas planvendosjes, vendosje e boilerit me kapacitet 12 litra per uje sanitar.
- Restaurimi i dyerve ne katin perdhe (porta hyrese kryesore, porta e tualetit, portat e zyrave ne katin perdhe, porta hyrese ne korridorin e zyrave, porta e depos ne ktin perdhe jashte tek hajati, duke perfshire kornizat, sipas percaktimeve ne planimetri dhe ne tabelen bashkengjitur. Restaurimi i tre dyerve ne ambientin e korridorit dhe arkives ne katin e pare teknik duke perfshire kornizat, sipas percaktimeve ne planimetri dhe ne tabelen bashkengjitur.
- Restaurimi i dritareve dhe qepenave prej druri perfshire kornizat e tyre ne teresine e objektit, duke respektuar, formen, hapjen, materialin dhe ngjyren ekzistuese.
- Restaurimi i pjeseve te demtuara te tavaneve prej derrase, duke respektuar rigorozisht detajin dhe materialin ekzistues perfshi ngjyren dhe materialin.
- Restaurimi i dyshemese prej derrase ne siperfaqen e çardakut duke respektuar rigorozisht detajin dhe materialin ekzistues perfshi ngjyren dhe materialin.
- Restaurim i podeve prej druri te ekspozitoreve ne katin perdhe me shtrese derrase FM 2.5 cm.
- Parmak çardaku me lende druri, ngjyre, dhe model njesoj me origjinalin.
- Pergatitje dhe vendosje lende e sharruar pise (kollonat e çardakut qe zevendesohen kati perdhe dhe brezi poshte parmakut). Kollonat do te behen 20 x 20 cm njesoj si ne katin e siperm, duke bere keshtu rikthimin ne identitet te tyre me dimensionin origjinalreferuar analizes historike.

## Punime për konservimin dhe restaurimin e Muzeut Etnografik Elbasan

- Shkalla e brendshme mendohet të restaurohet në një fazë të dytë, për shkak se zhvilluesi Bashkia Elbasan nuk ka mundësi financiare ta realizojë këtë punim brenda fondit të miratuar për vitin 2024, nga ana e Keshillit Bashkiak Elbasan.

- Gjithashtu nuk do të ketë punime të parashikuara për sistemimin e jashtëm në fazën e parë të investimit, pra në këtë projekt. Nderhyrjet në oborr do të realizohen në një fazë të dytë për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve të planifikuara nga zhvilluesi gjatë këtij viti.

- Dyshemeja e katit perdhe e cila është me lluster çimento me ngjyrë të kuqerremte, do të restaurohet me shtresë lluster çimento dysheme 1:2 kati perdhe në pjesët e percaktuara në planimetrinë e nderhyrjeve me pigment me ngjyrë të kuqerremte si origjinali.

- Persa i perket dyshemeve të mbeten pa u trajtuar në këtë fazë investimi, ato do të trajtohen në një fazë të dytë së bashku me dyshemetë prej derrase të katit të I-re teknik, përveç dyshemesë së çardakut e cila është planifikuar të realizohet brenda këtij projekti në fazën e parë sepse gjendja e tij është emergjente dhe perben rrezik për turistët dhe punonjësit e muzeut.

### C. Specifikimet Teknike

#### 1. PUNIMET E PRISHJES (ÇMONTIMI I ELEMENTEVE TË DEMTUAR)

Punimet e prishjes në restaurim janë një proces i rëndësishëm, në të duhet të marrin pjesë punëtorë të cilët duhet të mbikëqyren në çdo rast nga drejtuesi i punimeve. Nëpërmjet prishjes evidentohen gjurmë të reja të cilat sjellin dëshmi të reja lidhur me monumentin të cilat duhet të dokumentohen. Materialet e nxjerra nga prishja në shumicën e rasteve ripërdoren.

##### 1.1 Skeleritë

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat

sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri çeliku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parrakë vertikale, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parrakë vertikale, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

### 1.2 Metoda e prishjes

Puna për prishje / çmontim do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.

### Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

- a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet.
- b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperiencë.
- c) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit.
- d) Per çdo proces pune dhe çdo dite ne kantier duhet te mbahet libri i sigurimit teknik te punetoreve.
- e) Pajisja e punetoreve me veshje, doreza, kaske kantieri, kepuce kantieri, litare dhe rripa sigurimi, jeleke fosforeshente kantieri, etj., sipas rregullave te sigurimit teknik gjate punes te cilat jane ne fuqi.
- f) Rregullorja e sigurimit teknik duhet te afishohet ne nje vend te dukshem, si dhe tabela e kantierit dhe nje perimeter sigurie per kalimtare.

### 1.3 Prishje e suvatimit të degraduar në faqet e jashtme dhe te brendshme

Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhezohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrollojë në objekt të gjithë sipërfaqen me suva të degraduar

brenda dhe jashtë objektit. Sipërfaqja e suvatuar do të kontrollohet e gjitha duke evidentuar suvatimin e shkëputur, i cili do të prishet deri në gur ose deri në derrase për rastin e çatmase. Prishja e suvasë së dëmtuar do bëhet me shumë kujdes në mënyrë që të mos humbasim ndonjë gjurmë të mundshme që mund të fshihet poshtë saj. Suvatë mbi murin e guri dhe çatma do të kontrollohen dhe në prezencë të mbikqyrësit të punimeve në mënyrë që të gjykojë shkallën e ndërhyrjes. Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e sipërfaqes të cilës do ti hiqet suvaja e degraduar brenda dhe jashtë. Sipërmarrësi do të realizojë prishjen e të gjithë sipërfaqes me suva të degraduar. Gjatë procesit të prishjes duhet të kihet kujdes që të mos dëmtohen detajet arkitektonike. Sipërmarrësi do të heqë të gjitha copat dhe lëndët organike që rezultojnë nga prishjet në vendin e punës dhe do ti hedhin ato në përputhje me ligjet e shtetit, planin e menaxhimit mjedisor dhe me kërkesat e këtij specifikimi. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesshme të shtresës së suvasë së dëmtuar, skeleri si dhe transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia Elbasan.

### **1.4 Pastrim i mureve të gurit dhe çatmase nga shtresa e gëlqeres dhe myqet .**

Pastrimi dhe kruajtja e shtresave të gëlqeres do bëhet me shumë kujdes në mënyrë që të mos dëmtojmë muraturën e saj. Pastrimi do të bëhet me furcë teli të ashpër dhe spatul dhe do të shpëlahet me ujë të bollshëm në muret e gurit. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për pastrimin dhe heqjen e kujdesshme të shtresave të gëlqeres, myqeve dhe mbetjeve të tjera, transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

### **1.5 Prishje e elementeve të dëmtuar të çatise me tjegulla vendi**

Prishja e elementeve të dëmtuar të çatise do bëhet duke hequr elementet si: tjegullat e demtuara, elementet e drurit të demtuara.

Të gjithë elementet përberës të çatise demtohen sipas rradhës duke i pastruar nga gozhdet dhe duke i sistemuar materialet që do të riperdoren në një vend të vecantë në kantier (oborr).

### **1.6 Transport mbetjesh ndërtimi, me auto.**

Përveç sa është përshkruar më sipër, i gjithë materiali i mbetur (mbeturinat) do të hidhen nga Sipërmarrësi në zonë të siguruara prej tij dhe të miratuara nga Supervizori i objektit. Çdo material i planifikuar për të mbetur pronë e ndërmarrësit ose do të grumbullohet në grumbuj të pastër ose do të ngrakohet dhe do të transportohet tek zonat e planifikuara për ruajtje. Sipërmarrësi inkurajohet të veprojë me autoritetet lokale në vendosjen e përdorimeve të mundshme për ndonjë material të hedhur dhe në ngritjen e zonave të ruajtjes.

## 2.PUNIMET E RESTAURIMIT

**2.1** Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në KKTKM si dhe parimet e “Kartës Shqiptare të Restaurimit” – VKM Nr.426 on 13 Korrik 2007 dhe ligjeve të tjera në fuqi.

### 2.1.1 Shpjegim i terminologjisë

“Konservim” janë të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në vepër siç janë krijimi i kushteve mjedisore (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, mbrojtja nga pluhurat, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), si edhe ndërhyrjet kimike direkt në objekt apo vepër, me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.

“Ndërhyrje” është tërësia e masave të ndërmarra dhe operacioneve të kryera në vepër, me qëllim ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe nxjerrjen në pah të vlerave të saj.

“Restaurimi” është vlerësimi i thelbit origjinal të monumentit nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjen në pah të vlerave të tyre.

Këshillat mbi Parimet dhe Metodatat të cilat ofrojnë udhëzimet e propozuara të ndërhyrjeve restauruese duhet të lexohen së bashku me këtë dokument.

### 2.1.2 Ndërhyrjet në “monumentet e kulturës”

Në disa raste nevojat për konservim duhet ti paraprijnë atyre të vendosjes në siguri, në vazhdim nuk është e nevojshme të rregullohen nivelet e sigurisë të një ndërtese historike me ato ndërtesave të reja por është e mjaftueshme që nivelet e sigurisë të përmirësohen krahasuar me ato para ndërhyrjes.

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi duhet të realizohet pa prodhuar modifikime substanciale në sjelljen e strukturës dhe ndërtesës duke përdorur për sa është e mundur teknika ndërhyrje dhe metodologji operative tradicionale, konservim të materies, kushteve fizike dhe morfologjike. Teknika dhe materiale me karakter të rikthyeshëm edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llogjikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e restaurimit . Më tej ajo mbulon te gjitha punimet që lidhen me realizimin sa më rigoroz të ndërhyrjeve restauruese.



### 2.1.3 Restaurim Çati me tjegulla vendi (te ngjashme me ato ekzistuese)

Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhëzohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrollojë në objekt të gjitha zonat në të cilat do të realizohet nderhyrja restauruese në çati dhe do të behet nje sondazh i kujdesshem i konstruksionit te çatise. Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e siperfaqes ku do të realizohet ndërhyrja. Në zë pune përfshihet restaurimi i çatisë ku do të merret parasysh riparimi dhe zëvendësimi i elementëve të saj drusor te demtuara ne te gjithe siperfaqen e saj. Konsolidim dhe trajtim të elementëve të konstruksionit që do të ruhen. Duhet patur parasysh, që të largohen të gjitha elementet mbajtëse, që janë të dëmtuara ose të kalbura dhe të zëvendësohen ato me të reja, të cilat t'i plotësojnë KTZ dhe kërkesat e projektit.

Pasi ka përfunduar heqja e kujdesshme e tjegullave dhe seleksionimi i tyre, duke i sistemuar sipas grupimeve në oborr.

Restaurimi do të fillojë me:

1. Plotësimi i konstruksionit të drurit të çatisë së degraduar, duke respektuar përmasat e konstruksionit të hequr dhe skemën ekzistuese të çatisë. Gjendja e elementëve të konstruksionit do të kontrollohet nga supervizori i cili do të vendosë se cilët elementë do të ruhen dhe cilët jo. Elementet të cilët janë kalbur dhe kanë pësuar ulje do të zëvendësohen më të rinj të të njëjtës përmasë dhe lloji, të tjerët do të restaurohen duke iu nënshtruar një trajtimi dizinfektues ndaj agjentëve atmosferikë dhe krimbave e kërpudhave me antimol e insekticid. Trarët në pjesën mbështetëse të murit do të lyhen më zift ose material kundër lagështirës, në të gjitha rastet trarët ndërmjet tyre, do të kapen me ganxha metalike. Lenda e drurit e perdorur te jete e lyer me vaj te djegur.

2. Lyerja e pjeseve te reja të drurit të rivendosur me solucion antimol dhe vaj lini.

3. Plotësimi i dyshemesë së drurit nen tjegulla me petavra 2.5 \* 15÷20 cm. Petavrat në gjendje të mirë do të ripërdoren dhe ato të degraduara do të largohen nga kantieri. Dyshemeja me petavra pas përfundimit do të trajtohet me solucion antimol, anti lagështirë, insekticid dhe në fund do të lyhet me 2 duar vaj lini.

4. Shtrim i fletës hidroizoluese 1 k katrama.

5. Rivendosja e tjegullave te vendit ne gjendje te mire dhe zevendesimi me tjegulla te reja te njejta me origjinalin te atyre te demtuara. Tjegullat e reja te vendosen ne pjesen e siperme dhe ato te riperdorura dhe ne gjendje te mire ne pjesen e poshtme te mbuleses.

Lënda e drurit e cila do të përdoret per riparim do të jetë dru pishe i stazhionuar mirë dhe e cilësisë së lartë, me karakteristika:

Lagështi jo më tepër së 12 %,

Peshë volumore 410 – 540 Kg/m<sup>3</sup>,

Kufiri i rezistencës në tërheqje 130 MPa,

Materiali dru që do të përdoret për restaurim të jete pishë i staxhionuar.

Do të vendoset shtresa hidroizoluese.

Mbulimi do të bëhet me tjegulla vendi të vjetrat dhe të rejtat të njëjta si origjinali.

Kulmet e çatisë të mbyllën me llac gelqere.

Të gjitha materialet që do të përdoren do të jenë të pajisura me çertifikatë cilësie.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të sipërpërmendura.

### **2.1.4 Hidroizolimi i çatisë.**

Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhëzohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrollojë në objekt të gjitha zonat në të cilat do të vendoset membrana hidroizoluese. Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e sipërfaqes ku do të realizohet ndërhyrja. Membrana hidroizoluese e çatisë do të përzgjidhet në konsultë me supervizorin e punimeve në mënyrë që të përshtatet me kushtet specifike që kërkon çatia me tjegulla vendi. Kontraktori do të sjellë kampionë të ndryshëm të çertifikuar, nëse ato nuk ofrojnë karakteristikat e kërkuara nga mbikqyrësi i punimeve do të refuzohen. Është mirë që këto membrana të sigurojnë ajërosje të çatisë.

Të gjitha materialet për hidroizolim duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në normativa. Trashësia e saj do të jetë me një minimum prej 4mm.

Kujdes i veçant duhet të merret në përgatitjen e sipërfaqeve të papërshkueshme nga uji; ndonjë pikë e mundshme e hapur duhet të mbyllet me silikon dhe të stukohet.

Hidroizolimi duke realizuar mbivendosjen e shtresave (minimumi prej 12 cm) do të ngrihet në drejtimin vertikal në muret anësorë me min. 10 cm. Të bëhet kujdes dhe të lihet një rezervë në pjesën vertikale të bashkimit të çatisë me oxhaqet dhe baxhat ekzistuese.

Syngjerohet që shtresa hidroizoluese të sigurojë hidroizolim absolut kundër ujit, borës dhe lagështisë. Gjithashtu duhet të ketë një depërtueshmëri të kënaqshme të avullit që lejon kalimin e avullit por jo të ujit. Duhet të ketë peshë të lehtë ( $\leq 200 \text{ gr/m}^2$ ) dhe rezistencë të lartë mekanike. Rezistencë ndaj ndryshimeve të temperaturës  $-40^\circ\text{C} - +100^\circ\text{C}$ ). Rezistencë të lartë ndaj zjarrit.

### 2.1.5 Vendosje Impluve llamarine xingato

Ne thyerjet e çatise do te vendoset shtresa e impluveve me llamarine xingato perpara vendosjes se shtreses se tjegullave. Te merren masa qe tjegullat te mbeshteten mire ne te dhe te kete nje mbivendosje midis tyre rreth 10 - 15 cm ne çdo ane.

### 2.1.6 Suva mur guri fasade llac gelqere 1:2

Restaurimi i suvase ne pjeset e demtuara do te realizohet pasi eshte pastruar paraprakisht nga heqja e pjeseve te demtuara dhe te jete lare. Llaçi perdoret ne raport 1:2 me gelqeren dhe shtresa e restauruar do te perputhet ne trashesi me ate ekzistuese. Suvatë mbi mur guri do të kontrollohen dhe në prezencë të mbikqyrësit të punimeve në mënyrë që të gjykojë shkallën e ndërhyrjes.

### 2.1.7 Riparim suva mur guri brenda llac-gelqere 1:2

Restaurimi i suvase ne pjeset e demtuara ne faqet e brendshme kati perdhe, pasi eshte pastruar paraprakisht nga heqja e pjeseve te demtuara. Llaçi perdoret ne raport 1:2 me gelqeren dhe shtresa e restauruar do te perputhet ne trashesi me ate ekzistuese. Suvatë mbi mur guri do të kontrollohen dhe në prezencë të mbikqyrësit të punimeve në mënyrë që të gjykojë shkallën e ndërhyrjes.

### 2.1.8 Zevendesim i shtreses ekzistuese me pllaka gres ne tualet

Pllakat do te jene te dimensineve 31.6x31.6 , gres porcelanato nje brumeshe, jo luçidato. Ngjyra e tyre do te percaktohet nga supervizori. Pllakat do te jene «zgjedhje e pare» te verifikuara ne ambalazhim. Pllakat do te shrohen me kolle, mbi nje siperfaqe grezo me llaç çimento pasi te jete verifikuar nivelimi i saj me nje proces verbal. Nivelimi te behet pasi te jete cmontuar pllaka ekzistuese. Pllakat do te shtrohen me fuga qe formojne nje kend 90 grade me faqet e murit te tualetit. Shtrimi i tyre duhet te jete pa nderprerje pra fugat te jene ne vazhdimesi.

### 2.1.9 Zevendesim i veshjes ekzistuese me pllaka majolike ne tualet

Veshje për një lartësi sipas lartësisë së shtresës ekzistuese e cila duhet të çmontohet, me pllaka majolike me permasat e miratuara nga supervizori të cilësive të pare, furnizuar dhe vendosur në objekt mbi një siperfaqe të përgatitur me pare, e ngjitur me kolle, stukim me çimento të bardhë ose me nuancën e pllakes, pastrim i plote, skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e veshjes në mënyrë perfekte. Të behet kujdes të nivelohet suvaja e murit përpara vendosjes së pllakes me kolle.

### 2.1.10 Instalime hidrosanitare ne tualet

Ketu perfshihen teresia e punimeve per restaurimin e impjantit ekzistues te furnizimit me uje dhe shkarkimeve te tualetit, duke perfshire dhe materialet respektive sipas standarteve ne fuqi.

Do te behet furnizimi me uje nga rrjeti. Uji nga rrjeti do te shkoje ne rezervuar dhe direkt ne rubineta. Nje linje uji do te shkoje ne kaseten e shkarkimit te WC-se ku do te jete instaluar dhe nje tub uji per pastrimin e tualetit dhe linje tjeter do te shkoje tek lavamani.

Ne tualetin ekzistues do te montohen 1 WC allafranga porcelani, nje bolier per furnizimin me uje te nxehte 12 litra dhe nje lavaman me mishilator me kollone porcelani.

Rrjeti i shkarkimit te ujrave do te restaurohet ai ekzistues.

Te gjitha rrjetet e tubacioneve do te jene plastike si ai i furnizimit me uje ashtu dhe ai i shkarkimit, sipas standarteve ne fuqi.

F.V. Depozite metalike 200 litra ne veri te objektit sipas percaktimit te planvendosje, prane tualetit. Depozita do te vendoset mbi nje strukture me konstruksion te thjeshte metalik te parapergatitur (pasi nuk ka hapesine ne brendesi te tualetit), per te siguruar furnizimin me uje te rrjedhshem te tualetit ne çdo orar, pasi eshte tualeti i vetem i objektit i cili eshte ne dispozicion te punonjesve, por edhe te turisteve qe vizitojne muzeun.

### 2.1.11 Restaurim i suvase se çatmase brenda dhe jashte.

Restaurimi i suvase se çatmase ne pjeset e demtuara ne faqet e brendshme dhe te jashtme, pasi eshte pastruar paraprakisht nga heqja e pjeseve te demtuara. Llaçi perdoret ne raport te njejte dhe shtresa e restauruar do te perputhet ne trashesi me ate ekzistuese. Suvatë ne çatma do të kontrollohen dhe në prezencë të mbikqyrësit të punimeve në mënyrë që të gjykojë shkallën e ndërhyrjes dhe te respektohen KTZ ne fuqi.

### 2.1.12 Restaurim tavan dhe korniza me rrjete teli dhe suva llaç gelqere 1:2

Kujdes duhet te tregohet ne raportin e pergatitjes se llaçit me gelqeren. Kornizat dhe dekoret me suva duhet te restaurohen me shume kujdes duke ruajtur trashesine e suvase ekzistuese dhe duke ruajtur kurbat dhe dizenjon ekzostuese te çdo elementi dekorativ. Pasi suvaja dhe mbushja e restauruar te jete thare mire do te kruhet me leter zmeril dhe do te bojatiset me dy duar gelqere, si pjesa tjeter e muratures dhe suvase.

### 2.1.13 Restaurim i podeve prej druri te ekspozitoreve ne katin perdhe me shtrese derrase FM 2.5 cm

Lenda e sharruar e derrases se pishes me trashesi 2.5 cm, pasi zmerilohet dhe pritset njesoj si pjeset e cmontuara te demtuara, trajtohet paraprakisht me solucion insekticid dhe vaj lini dhe lidhet ne te njejten menyre me ate ekzistues me pjesen e pademtuar. Te gjithë podet do te lyhen me vaj lini per te unifikuar pamjen.

### **2.1.14 Parapet çardaku me lende druri njesoj me origjinalin, breza nen te, dekori, zevendesim i kollonave prej druri ne katin perdhe tek hajati.**

Restaurimi i parapetit (parmakut dekorativ) te çardakut, kollonave, brezit prej druri nen parmak do te realizohet me dru pise ne permasa, dizajn dhe ngjyre te njejte me ate ekzistues. Te gjithë elementet drusore ku ai mbeshtetet do te restaurohen me dru pise te sharruar, te stazhionuar dhe trajtuar paraprakisht. Te respektohet ne menyre rigoroze modeli ekzistues. Te gjithë elementet do te lyhen me vaj lini per te unifikuar pamjen. Punimet ne çardak per zevendesimin e kollonave do te realizohet pasi te jete kryer puntelimi me kujdes i çardakut, me qellim mos demtimin e elementeve ne katin e siperm.

### **2.1.15 Restaurim tavan dhe dysheme derrase i demtuar pjeserisht**

Restaurimi i tavanit ne pjesen e demtuar nga lageshtia do te realizohet me dru pise ne permasa, dizajn dhe ngjyre te njejte me ate ekzistues. Lamat e derrases do te restaurohen me dru pise te sharruar, te stazhionuar dhe trajtuar paraprakisht. Te respektohet ne menyre rigoroze modeli ekzistues dhe trashesia ekzistuese, nen mbikqyrjen e supervisorit. Pjesa tjetere vetem do te trajtohet me 2 duar vaj lini.

Restaurimi i dyshemese prej derrase do te realizohet ne pjesen e çardakut sipas percaktimeve te mesiperme.

### **2.1.16 Restaurim dritare dhe dyer druri + qepena aty ku ka**

Restaurimi i re gjitha dritareve te objektit ne te dy katet dhe te dyerve ne katin perdhe te specifikuara paraprakisht, do te realizohet me dru pise ne permasa, dizajn dhe ngjyre te njejte me ate ekzistues. Dritaret dhe qepenat prej druri aty ku ka do te restaurohen me dru pise te stazhionuar dhe trajtuar paraprakisht. Te respektohet ne menyre rigoroze modeli ekzistues, menyra e hapjes se kanateve vertikale dhe horizontale siç jane tani, nen mbikqyrjen e supervisorit. Restaurimi do te perfshije dhe kornizat e tyre si dhe dekoret prej druri ne pjeset e demtuara. Pjesa tjetere qe nuk eshte e demtuar vetem do te trajtohet me 2 duar vaj lini.

### **2.1.17 Lyerje brenda dhe jashte me gelqere.**

Pastrimi dhe kruajtja e shtresave të gëlqeres te shkeputura dhe te shtresezuara ne vite do bëhet me shumë kujdes në mënyrë që të mos dëmtojmë suvane e muraturës dhe çatmase . Pastrimi do

të bëhet lehtësisht me furcë teli aty ku shihet e nevojshme dhe me pas me leter zmerile. Pastaj do të realizohet bojatisja në fillim me një shtresë të trashë sherbet gelqere të përqendruar duke mbrojtur paraprakisht elementet drusore, dyert, dritaret, dyshemetë dhe tavanet me tenije. Pasi të thahet shtresa e parë e bojatisjes ushtrohet një dorë tjetër me gelqere me përqendrim mesatar. Të bëhet kujdes që furça të përdoret me levizje në dy drejtime për të evituar vijat dhe për të unifikuar bojatisjen.

### 2.1.18 Lyerje me 2 duar vaj lini i elementeve drusorë

Lyerja e elementëve drusorë do të bëhet për të mbrojtur këto elemente si dhe uniformizuar ngjyrën e të gjithë këtyre elementëve.

Për elementët origjinalë të lyer me vaj lini do të pastrohet paraprakisht sipërfaqja nga pluhurat dhe depozitimet me kompresë me ujë të ngrohtë si dhe me alkool të holluar në ujë dhe më pas do të vazhdohet lyerja me vaj lini pa ngjyrë në mënyrë që të evidentohet ngjyra origjinale e elementëve.

- Për elementët drusorë të lyer me bojë vaji apo llak, do të bëhet pastrimi e zmerilimi i sipërfaqes sic e kemi shpjeguar më sipër në mënyrë që të arrihet përthithja e vajit të linit me ngjyrë të errët sipas ngjyrës së evidentuar të elementëve origjinalë.

Vaji i linit duhet të jetë i shumë i pastër, me erë të fortë dhe shije të hidhur, i papërzier me vajëra mineral, vaj peshku apo të ndonjë lloji tjetër. Nuk duhet të lërë asnjë depozitim mbetje nëse e hedhim në lastër qelqi apo metali. Duhet të lihet të thahet komplet në intervalin e 24 orëve. Nuk duhet të ketë më tepër se 7% aciditet, 1% papastërti dhe në temperaturën 15°C një densitet 0.91-0.93. Lyerja duhet të bëhet me vaj lini.

Përpara fillimit të këtij procesi mbikqyrësi i punimeve të restaurimit, duhet të bëjë një kontroll të kujdesshëm të përcaktojë dhe lërë qartë detyrat kontraktorit për trajtimin e secilit element sipas përcaktimeve të mësipërme.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve për lyerjen e elementëve të drurit me vaj lini të paktën dy duar, blerjen e materialit, transportin, skeleri dhe çdo punë që lidhet me të.

Ky çmim është për njësi Lekë/m<sup>2</sup>.

### 2.1.19 Lyerje me antimol

Mbrojtja e drurit nga mikroorganizmat dhe insektet të natyrave të ndryshme, kërkon ndërhyrje të niveleve të ndryshme: eliminim të substancave të alterueshme që përmban druri, apo mbrojtja e tij me insekticid që përvec se pengojnë rritjen e mikroorganizmave, kërpudhave dhe insekteve mund edhe të parandalojë përthithjen e padëshiruar të ujit nga ambienti nëse ai është vajor.

Trajtimi me insekticid i drurit dhe substancat e përshtatshme për një disinfektim korrekt duhet të ndjekin këto faza:

- biocidi duhet të godasë direkt larvat dhe vezët në mënyrë që ti eliminojë totalisht.
- të gjitha zonat me sipërfaqe të ekspozuara duhet të trajtohen me insekticid dhe biocid të lëngshëm me penetrimit të lartë për të krijuar një zonë me helm përmes të cilës do të kalojnë insektet ksilofag për të dalë në sipërfaqe.
- trajtimi sipërfaqësor duhet të përmbajë një shtresë insekticidi në sipërfaqe dhe në të gjitha carjet e drurit;

Ndërhyrja e dezinfektimit duhet të jetë e tillë që të eliminojë agjentët biologjikë negativë ekzistues dhe të parandalojë degradime të mundshme të materialit drusor në të ardhmen.

Solucioni do të aplikohet me spruco apo me penel, duke përsëritur trajtimin 2/3 herë rradhazi, për të lejuar insektin të penetrojë në dru sa më thellë të jetë e mundur. Duhet evituar përdorimi i produkteve në tretësirë ujore pasi kapaciteti i penetrimit varet nga lagështia e drurit.

Përpara përdorimit të insekticidëve (kanë avantazhin që nuk kanë erë), është e nevojshme lagia e drurit me ujë para çdo aplikimi. Me një 1kg insekticid mund të trajtohet një sipërfaqe prej 3m<sup>2</sup>. Insekticidët e shkrirë në tretës organik preferohen të kenë kapacitet të madh penetrimi në drurin e thatë përmes një procesi të shpërndarjes dhe përthithjes në thellësi. Insekticidet duhet të jenë eksperimentuar edhe më parë dhe të jenë të pranuar nga praktika restauruese duke plotësuar kriteret që të jenë jotoksikë, rezistent ndaj dritës dhe rrezeve UV dhe të mos prodhojnë alterime kromatike.

Produktet e përdorshëm për desinfektim mund të jenë:

Desinfektimi i trarëve të çatisë – do të përdoren tretësa në ujë vetëm në kushte të vecanta dhe do jenë me bazë të përzierjes së fluorit të natriumit dinitrofenol dhe bikromat, poliborat natriumi. Kërpudhat – trajtimi antimyk (kundër kërpudhave) do parashikojë produkte efikas edhe kundër insekteve, do të trajtohet në përgjithësi produkte me bazë fluori të përbërë nga kromi dhe arseniku, pentaklorofenol etj. Është e rrallë që kërpudha të ketë kapacitet të zhvillohet në lagështi më të vogël se 22%, dmth vlera të lagështisë 12/14% përjashtojnë cdo rrezik, në cdo rast druri që do të përdoret duhet të jetë i stazhionuar.

Pas kryerjes së ndërhyrjes që garanton eliminimin dhe/ose parandalimin nga një nivel anomal lagështire, elementët drusor të infektuar dhe që nuk plotësojnë standartet teknike të përdorimit mund të hiqen apo digjen. Mund të rezultojë i nevojshëm të kryhet një ndërhyrje radikale nëpërmjet injeksioneve me biocid.

Shkalla e degradimit të elementëve drusorë do të gjykohet pas hapjes së cative dhe mbikqyrësi i punimeve do të vendosë mënyrën dhe llojin e aplikimit për elementët drusorë.

Në përgjithësi substancat antiseptike preferohen me fuqi të madhe të biocidit dhe të mos jenë të dukshëm pas aplikimit.

Përbërësit me fluor janë të përshtatshëm për eliminimin e kërpudhave.

Mund të jetë e nevojshme përdorimi i disa përzierësave për të arritur një përmirësim të biocidit. Do të preferohen përzierje me bazë fluori apo dinitrofenol dhe florur natriumi (raport 11:89) me shtesë ose jo të arsenikut; përzierje të florurit me kripëra të arsenikut të natriumit;

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve për lysterjen e elementëve të drurit me insekticid e biocidë sipas metodologjisë dhe materialeve të përshkruar me të paktën dy duar, blerjen e materialit, transportin, skeleri dhe çdo punë që lidhet me të.